

PROFILI I
SHOQËRISË

2020



BREGU SH.A



MISIONI DHE VIZIONI

Shoqëria Bregu sha. ka si mision të ofrojë shërbime të standarteve të larta në industrinë e ndërtimit dhe projektimit, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë; për të shtuar vlerë për klientët përmes inovacionit, teknologjisë, integritetit dhe performancës absolute.

Vizioni ynë është të zgjerojmë portoflin tonë të punimeve në rajon dhe më gjerë dhe të jemi pikë referimi për inovacionet në fushën e ndërtimit në Shqipëri!

“ Bregu sh.a 2020





RRETH NESH

Shoqëria "Bregu sh.a" u themelua në vitin 1991 në qytetin e Korçës dhe ka filiale në qytetin e Tiranës, Podgoricës dhe Shkupit. Shoqëria "Bregu sh.a" ka një eksperiencë shumëvjeçare në ndërtimet civile dhe industriale, turizëm, restaurim, infrastrukturë rrugore, kanalizime, ujësjellesa dhe vepra të artit. Shoqëria "Bregu sh.a" zotëron një konglomerat burimesh që diversifikojne nga njëri tjetri në termat e burimeve njerëzore, pajisjeve teknologjike të projektimit dhe burimet fizibël të standarteve evropiane, të cilat të integruara me eksperiencën e gjatë ne treg, përbëjnë nje avantazh krahasues të shoqërisë në realizimin e projekteve në kohë, cilësi dhe brenda buxhetit.

Të përzgjedhur vazhdimisht nga "Bashkimi Evropian" si një shoqëri e besueshme dhe etike për implementimin e projekteve të rëndësisë së veçantë, shoqëria "Bregu sh.a" fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit dhe integrimin me metodat më bashkëkohore të ndërtimit.



VENDNDODHJET E SHOQËRISË

MALI I ZI ●

SHQIPËRIA ●

MAQEDONIA
E VERIUT ●



HISTORIKU

1991-1998

Shoqëria “Bregu Sh.a” u themelua në vitet 1991-1993 në qytetin e Korçës. Gjeneza e shoqërisë nisi me ndërtimin dhe rikonstrukcionin e vilave më të vjetra në Korçë, të shkollave dhe kopshteve si: “24 Maji”, Shkolla e “Gjuheve të Huaja”, Shkolla “Naim Frashëri”, Shkolla “Raqi Qirinxi”, Kopështi “19”, Konvikti i Shkollës Mjekësore, Shkolla “Nuçi Naçi”, ndërtimin e banesave private dhe një sërë instucionesh të tjera të një rëndësie të veçantë. Në vitet 1994-1998 u realizuan projektet e ndërtimit të “PTT Korçë” dhe Shkollës së Mesme në Fshatin Vashtmi të rrethit Korçë. Në këto vite Shoqëria investoi dhe ndërtoi pallatin e parë rezidencial.

1998-2000

Në vitin 1998 u realizuan projektet e ndërtimit të “Ujësullës së Bulgarecit”, spitaleve në Maliq dhe Bilisht, lidhja kabllore në qytetin e Korçës. Një projekt i rëndësishëm në fushën e rikonstrukcioneve në këto vite është dhe ai i “Mësonjëtores së Parë Shqipe” në Korçë, për nga vlerat që trasmeton në shoqëri. Në vitet 1999 – 2000, “Bregu Sh.a” vazhdoi të zgjerojë portofolin e saj të ndërtimeve në Banesat Kolektive me shumë kate. Ndërtime dhe rikonstrukcione të institucioneve kulturore dhe publike. Ndër të cilat: Ujësullësa, Kanale Vaditëse, Kontrata CWC 15 dhe CWC 16, Antena Telefonike Radiotrasmetuese, Spitale, Nën stacione elektrike etj.

2000

Historia e suksesit vijon në vitet 2000-2004, ku “Bregu Sh.a” bashkëpunon me ndërmarrje të ndryshme shtetërore për të ndërtuar godina të rëndësishme për shoqërinë, si: shkolla, spitale dhe objekte të tjera, të cilat ndikuan në përmirësimin e jetesës në komunitet.

2005

Vitet 2005-2007 shënojnë një periudhë zhvillimi të mëtejshëm për shoqërinë “Bregu Sh.a” dhe integrimin e manaxhimit të projekteve me elementë inovatorë. Me anë të një bashkëpunimi të suksesshëm me “Delegacionin European” në Shqipëri, u implementua projekti për ndërtimin e “Burgut të Sigurisë së Lartë” në Korçë. Ky partneritet shënoi edhe pikënisjen për manaxhimin të shumë projekteve të tjera të mbështetura nga “Delegacion European”.

2008-2014

Përgjatë viteve 2008-2010 shoqëria vazhdoi bashkëpunimin në investime strategjike të “Delegacionit European”, PIU dhe ndërtimin e “Qendrës për ri-integrimin e Minorenëve” në Kavajë, financuar nga BE. 2011-2014, shoqëria “Bregu Sh.a” vijoi të përmirësonte kapacitetet teknologjike, duke ju përshtatur niveleve europiane. Realizimi i projekteve sfiduese, në standarte të larta, solli përzgjedhjen e shoqërisë për zbatimin e projektit të rikonstrukcionit dhe ndërtimit të “Akademisë së Policisë” në Tiranë, financuar nga BE. Po në këto vite, filloi zbatimin edhe projekti i ndërtimit të pallatit “Rezidenca 1”, në rrugën Mihal Grameno, Tiranë.

2015

Viti 2015 shënoi fillimin e tre projekteve sfiduese dhe me rëndësi strategjike për shtetin shqiptar, të financuara nga BE. “Pika e kalimit kufitar Hani i Hotit” dhe “Pika e kalimit kufitar Bozaj” kanë objektiv kryesor përmirësimin e tregtisë rajonale duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj sipërmarrjeve dhe qytetarëve. Komponentët e projektit, janë rikonstrukcioni i pikës së kalimit doganor, godina e kontrollit të vijës së dytë dhe terminali i ri doganor. “Kompleksi i Forcave Speciale Renea”, parashikon ndërtimin e një kompleksi të ri stërvitor dhe akomodimin e “Forcave Speciale Renea”. Viti 2018 ishte viti i përfundimit të punimeve në projektet “Pika e kalimit kufitar Hani i Hotit” dhe “Pika e kalimit kufitar Bozaj” dhe vlerësimi i tyre me atributet maksimale nga instancat ndërkombëtare.

2019-2020

Viti 2019 nis me ndërtimin e së ardhmes! Planet dhe projekt-propozimet e reja, tepër sfiduese përkrahin një dimension më bashkëkohor në fushën e ndërtimit. Rezidenca kontemporane dhe pallate me dizajn unik që transmetojnë vlera të larta në komunitetin përreth, si: "Serenity Residence" dhe "Bazaar Gate". Në Janar 2020, u nënshkrua kontrata e ndërtimit të "Qendës Pritëse për Refugjatët" në Shkup të Maqedonisë së Veriut, një projekt i financuar nga "Bashkimi Evropian".

Bazaar Gate...

2019-2020

"Délicatessen Villa"
"Serenity Residence",
Qendra Pritëse për
Refugjatët, Shkup

2015

Pika e kalimit kufitar
Hani i Hotit dhe Bozaj,
Kompleksi i Forcave
Speciale Renea

2012-2015

Ndërtimi i "Rezidenca 1",
Rruga Mihal Grameno

2011

Ndërtimi i "Akademisë së
Policisë", Tiranë

2008

Qendra për ri-integrimin e
minorenëve, Kavajë

1991-1998

Ndërtimi i shkollave dhe
kopshteve në Korçë

1998

Ndërtimi i ujësjellësave
dhe spitaleve në Maliq
dhe Bilisht, Korçë

1998-2000

Rikonstrukcioni i
"Mësonjëtores së Parë
Shqipe", banesa kolektive

2000

Ndërtime të shkollave,
spiteleve dhe objekteve
me impakt në komunitet

2005

"Burgu i Sigurisë së
Lartë", Korçë

"DÉLICATESSE VILLA"

Elegante në design

Hapsira të ndriçuara

Ornamente klasike



7



"Délicatesse Villa" është projekti më i ri nga "Bregu sh.a" dhe pritet të nisë punimet në 2020. Projekti konsiston në 2 godina 3 katëshe të bashkëngjitura të cilat do ndërtohen sipas një stili klasik të fasadës së jashtme dhe interior kontemporan në ambjentet e brendshme.

2019-2020

800 M²

APARTAMENTE

NJËSI SHËRBIMI

PËRTEJ ELEGANCËS...



Ndjesia e të banuarit në këtë rezidencë merr ngjyra pariziene dhe elegante, rozë gold dhe aromë kardamom. Ballkone franceze të dekoruara me ornamente klasike të trëndafilta, ju bëjnë të shijoni më tepër mëngjeset me një çaj të ngrohtë në Korçë

"SERENITY RESIDENCE"

ELEGANCË

NGROHTËSI

BARDHËSI



9



Serenity Residence është një kompleks banimi dhe shërbimi i përbërë nga 2 godina rezidenciale dhe 1 godinë 4 katëshe projektuar për të shërbyer si hotel! Serenity Residence ka marrë këtë emërtim sepse transmeton vlerat e Korçës duke patur një qasje elegante në dizajn, prezantim dhe trasmetim vlere. Duke përdorur një stil elegant në veshjen e jashtme të fasadës por edhe arredimin e brëndshëm, arrijmë t'i përshtatemi më shumë stilit tradicional. Me Serenity nuk krijojmë thjesht një rezidencë banimi, por arrijmë të krijojmë një pol me hapësira komerciale, shëtitore, pasazh për turistët dhe kënd njësimi me kulturën e Korçës!

2019-2020

4950 M²

○ APARTAMENTE

○ NJËSI SHËRBIMI

○ PARKING NËNTOKËSOR

ARTI I TË JETUARIT NË KORÇË!



10

Në Serenity Residence merr kuptim shtëpia juaj e ëndrrave e cila përçon ngrohtësi dhe dritë. Përdorim metodologjinë europiane të implementimit të punimeve dhe përzgjedhjes së materialeve duke respektuar me rigorozitet standartet EUROCODE për të garantuar cilësinë e lartë të ndërtimit të objektit! "Serenity Residence" ka një pozicion perfekt mes Pedonales së Korçës, Parkut dhe Katedrales Orthodoxke, në rrugën Ligor Rembeci! Kompleksi ka mundësi aksesimi nga të dyja akset rrugore!

"QENDRA PRITËSE PËR REFUGJATËT"



11



Bregu sh.a përzgjidhet sërish nga Bashkimi Evropian për implementimin e projekteve ndërkombëtare të rëndësishme të veçantë! Pas projekteve strategjike në Mal të Zi, "Bregu sh.a" ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e "Qendrës së pritjes së Refugjatëve" në Shkup të Maqedonisë së Veriut! Godina e re do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme për pritjen dhe akomodimin e refugjatëve, duke lejuar kështu zbatimin e duhur të të gjitha procedurave operative dhe sistemeve të kontrollit në përputhje me standartet evropiane.

2019-2020

4600 M²

○ QENDËR PRITJE

○ FJETINA

○ SUPORT

SHKUP, MAQEDONIA E VERIUT



Kontrata e punimeve e nënshkruar në Janar 2020, në Shkup të Maqedonisë së Veriut, përfshin por nuk është e kufizuar vetëm në ndërtimin e "Qendrës së Re Pritjes për Refugjatët", e pajisur me kontroll elektronik të hyrjes, dyerve speciale të papërshkueshme nga zjarri, alarmet dhe fikëset e zjarrit, supervizimin me anë të kamerave, dritaret e mbrojtura, sistemin e duhur të ventilimit, si dhe fasilite të tjera. Gjithashtu garantohet akses për personat me aftësi të kufizuar në godinë nëpërmjet rampave dhe ashensorëve të dedikuar.

"ROLLING HILLS LUXURY RESIDENCES"



13



"Bregu sh.a" ka ndërtuar 6 vila në Bllokun B4 dhe B5 në "Rolling Hill Luxury Residences"! Rolling Hills është një komunitet i rrethuar luksoz, më miri si standard ndërtimi dhe i pari i këtij lloji në Shqipëri.

2016-2019

2700 M² ○ VILLA

TIRANË, SHQIPËRI



I cili parashikon katër tipe vilash të cilat variojnë në madhësi prej 280-1,030m² dhe sipërfaqe trualli 550-2000 m². Kjo kontratë parashikon ndërtimin e 6 vilave përfshirë gërmimet, punimet e betonin, dhe punimet përforcuese, punimet në mure, rifinitura, elektrike, vepra mekanike dhe punime të jashtme.

"RIKONSTRUKSIONI I PIKËS SË KALIMIT KUFITAR"



15



Projekti i ndërtimit të "Pikës së Kalimit Kufitar të Hanit të Hotit" është një nga projektet me rëndësi të veçantë të shoqërisë "Bregu sh.a". Ky projekt është financim i Bashkimit Evropian i cili tashmë është partner strategjik i kompanisë prej 15 vitesh. Projekti i ndërtimit të pikës së kalimit kufitar nga Bregu sha. në partneritet me Delegationin Evropian, u finalizua në vitin 2018. Komponentët e projektit janë rikonstrukcioni i pikës së kalimit doganor, godina e kontrollit të vijës së dytë dhe terminali i ri doganor ku do të pozicionohet administrata e Doganës dhe Agjensitë Doganore për kryerjen e procedurave të zhdoganimit.

2015-2018

12000 M² ○ INFRASTRUKTURE ○ RRUGE 4350 M² ○ TENDA/ZYRA/INSPEKTIM ○ TERMINAL DOGANOR

HANI I HOTIT, SHQIPËRI"



Objektivi i investimit në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit është përmirësimi i kushteve të punës dhe cilësisë së shërbimit ndaj sipërmarrjes dhe qytetarëve, përsheptimi i tregtisë ndërkufitare duke kontribuar ndjeshëm në projektin e madh të tregtisë rajonale. Pika e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, konsiderohet si pikë e kalimit kufitar të kategorisë së parë, dhe është e vetmja pikë e kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, e hapur për transportin e mallrave me natyrë tregtare në rrugë tokësore, por edhe një pikë kyçe në kalimin e aksit që lidh Italinë e Slloveninë me Ballkanin Jugor.

"RIKONSTRUKSIONI I PIKËS SË KALIMIT KUFITAR "



17



Božaj është pika kryesore e kalimit kufitar të Malit të Zi. Pika e kalimit kufitar Božaj, në Malin e Zi është një ndër projektet më sfiduese dhe me rëndësi madhore të "Bregu sh.a", i financuar nga Bashkimit Evropian! Projekti konsistoi në zgjerimin e korsive të automjeteve nga 2 korsitë në 4 korsitë, ri-asfaltimin e të gjithë hapësirës doganore, krijimin e skarpatave mbrojtëse liqenore, ndërtimin e dy godinave të agjensive të specicionit të mallrave dhe godinës së inspektimit të kamionëve.

2016-2018

7000 M²



INFRASTRUKTURE



RRUGE

950 M²



GODINE INSPEKTIMI



GODINE AGJENCI DOGANORE

BOŽAJ, MALI I ZI"



Projekti i ndërtimit të "Pikës së kalimit kufitar Božaj", Mali i Zi provoi sërish për "Bregu sh.a" se sfidat na bëjnë më të fortë dhe më këmbëngulës në perfeksionimin e cilësisë! Objektivi ynë i përbashkët është përmirësimi i lidhjeve infrastrukturore ndërmjet vendeve të rajonit dhe ndërmjet rajonit me Bashkimin Evropian. Pasi përmirësimi i infrastukturës stimulon rritjen ekonomike që natyrisht sjell shtimin e vendeve të punës dhe oportuniteteve.

"KOMPLEKSI I FORCAVE RENEA"



Zbatimi rigoroz i EURO KODEVE dhe kontratës FIDIC na bën të jemi një ndër kompanitë më të respektuara në vend në industrinë e ndërtimit, duke u përzgjedhur vazhdimisht nga BE dhe duke sjellë gjithmonë një tjetër standart në ndërtim! I tillë është edhe kompleksi i ri i Forcave Renea. Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian dhe punimet përfunduan në vitin 2018

6500 M²

○ KOMANDA

○ FJETINA

○ VENDROJE

TIRANË, SHQIPËRI



20

RENEA është pjesë e Forcave Speciale të Policisë së Shtetit Shqiptar. Projekti shërben për krijimin e kushteve të nevojshme të infrastrukturës për Forcat Speciale për të rritur performancën e tyre drejt aktiviteteve të krimit të organizuar. Punimet përfshinin ndërtimin e bllokut të Konvikteve dhe Rekreacionit dhe ndërtimin e godinës së re të Hyrjes dhe Komandës dhe bllokut Task Force. Punimet kryesisht konsistojnë në ndërtimin e ri të ndërtesave (punime të betonit të armuar; punime me tulla; punime rifiniture, etj) dhe punime të infrastrukturës së jashtme.

"REZIDENCA 1-RRUGA MIHAL GRAMENO"



21



"Rezidenca 1" është e pozicionuar në qendër të Tiranës në rrugën "Mihal Grameno". Është e përbërë nga 6 kate mbi tokë, dhe -2 kate parkim nëntokë, sipërfaqe e gjelbëruar në të gjitha anët e pallatit, me ndriçim në të gjitha anët e tij dhe me një pamje panoramike. Ky projekt ka përmbyllur punimet e vitin 2016!

2012-2016

3950 M²

○ APARTAMENTE

○ NJËSI SHËRBIMI

○ PARKING NËNTOKËSOR

TIRANË, SHQIPËRI



Në "Rezidencën 1" në rrugën Mihal Grameno, janë të disponueshme ambiente biznesi në katin 0, për shitje! Objekti është ndërtuar nga "Bregu sh.a" me cilësi të standarteve europiane dhe ka akses të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore, duke siguruar një vizibilitet të lartë të biznesit tuaj. Ambjentet e shërbimit janë të përshtatshme për qendër estetike, bar-kafe në stilin duplex, agjensi udhëtimi, klinikë dentare etj. me sipërfaqe që variojnë deri në 81.27 m².

"AKADEMIA E POLICISË"



23



"Akademia e Policisë", Tiranë është një projekt i rëndësisë së veçantë, i perfunduar me sukses nga shoqëria Bregu sh.a. në vitin 2015 dhe financuar tërësisht nga Komisioni Evropian. Kontrata e punimeve përfshin shumëllojshmëri punimesh si: ndërtimi i qendrës sportive, fushave të lojërave sportive në natyrë, pritja për vizitorë dhe studentë të huaj, qendra pritëse për oficerët e moshuar, sheshi dhe objekti i stërvitjes taktike si dhe rehabilitimi i objekteve të tjera, konvikti për rekrutët e rinj, shkolla për fillestarët, kompleks trajnimi për oficerët, etj.

2011-2015

10.200 M² ○ GODINA STËRVITORE ○ ZYRA ○ QENDRA SPORTIVE

TIRANË, SHQIPËRI



Punimet përfshijnë instalimet elektromekanike, HVAC, sistemin sanitar si dhe punimet përfundimtare të peizazhit. Do të sigurohen shërbime të tjera publike: furnizimi me ujë, kanalizimi dhe sistemi i ujërave të stuhisë, sistemi i zjarrfikësve, sistemi i rrjetit të energjisë, si dhe rrugët dhe zonat e parkimit dhe çdo vepër tjetër infrastrukturore e nevojshme për funksionimin e duhur të ndërtesave brenda Qendrës së Arsimit Policor. Ky projekt konsistoi në ndërtimin e godinës stërvitore të forcave policore, duke bërë kështu që kjo godinë të krahasohet nga pikëpamja e strukturës dhe cilësisë së ndërtimit, me objekte të ngjashme në shtetet evropiane që kanë si qëllim ofrimin e trajnimeve formuese për forcat e rendit.

EKSPERIENCA SI PALË KONTRAKTORE

Më poshtë janë të listuara projekte me natyrë të ngjashme dhe rëndësi strategjike, të implementuara gjatë 5 viteve të fundit nga "Bregu sh.a" me financim 100% nga Komisioni Evropian.




Komisioni Evropian

Projekti i ndërtimit të kompleksit të trajnimit dhe akomodimit të "Akademisë së Policisë", Tiranë	Vlera e projektit	4,2 mln €
Projekti i ndërtimit të "Qendrës së Ri-integrimit të Minorenëve" në Kavajë	Vlera e projektit	1,7 mln €
Projekti i ndërtimit të "Pikës së Kalimit kufitar Hani i Hotit"	Vlera e projektit	2,5 mln €
Projekti i ndërtimit të "Pikës së Kalimit kufitar Bozaj"	Vlera e projektit	1.1 mln €
Projekti i ndërtimit të kompleksi zyrash për komandën dhe akomodimin e "Forcave Speciale Renea"	Vlera e projektit	2.2 mln €
Projekti i ndërtimit të "Qendrës së pritjes së Refugjatëve" në Shkup të Maqedonisë së Veriut	Vlera e projektit	1.5 mln €

Me një eksperience pune mbi 25 vjeçare, "Bregu sh.a" vijon të përzgjidhet nga BE si një nga shoqëritë më prestigjoze dhe të respektuara në vend në industrinë e ndërtimit!

SIPËRFAQE TË NDËRTUARA

Më poshtë është listuar sipërfaqja e ndërtimit të projekteve të ndërtuara nga Bregu sh.a gjatë 8 viteve të fundit, e specifikuar në projektet e financuara nga partnerët dhe projektet e financuara privatisht.




19.645 m2

Sipërfaqe të ndërtuara nga Bregu sh.a dhe të financuara nga BE dhe partnerë të tjerë



10.950 m2

Sipërfaqe të ndërtuara nga Bregu sh.a dhe të financuara privatisht



30.595 m2

Sipërfaqe të ndërtuara në total

CERTIFIKIME

27



UNI-EN-ISO 9001:2015



BS-OHSAS 18001-2007



UNI-EN-ISO 4001:2015



ISO 27001:2013



ISO 50001:2011



BS-PAS 99:2012



EN-ISO 3834-4:2005



PARTNERËT TANË



KOMISIONI EVROPIAN NË SHQIPËRI



KOMISIONI EVROPIAN NË MAL TË ZI



KOMISIONI EVROPIAN NË MAQEDONI



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME NË SHQIPËRI



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME NË MAL TË ZI



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME NË MAQEDONINË E VERIUT



MANETCI



BASHKIA TIRANË



BASHKIA KORÇË



107
VJETORI
I POLICISË SË SHTETIT






PROFILI I SHOQËRISË



ADRESA

Rr. "Dervish Hima",
Pallati Ambasador 3, Kati 2, D.11,
Tiranë, Shqipëri

RRJETET SOCIALE



www.bregugroup.al

2020